



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 186, Datë 16.11.2020

“MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC ZALL XHUXHË”
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2020, mbasi shqyrtoi dhe relacionin nr.119/3 prot, datë 11.11.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.1165 Prot, datë 03.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., është regjistruar në QKB në datën 01.10.2013, dhe mban statusin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (shpk).
- Në objekt të veprimtarisë së saj shoqëria “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., ka: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Zall Xhuxhë 1" dhe "Zall Xhuxhë 2", tek Autoriteti kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të Kontratës së konçesionit të formës BOT të lidhur me datë 09/09/2013, me nr.10329 Rep, nr. 3323 Kol.
- Aplikimi i shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” “e”, “f” dhe “g”) **është plotësuar pjesërisht.**
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) **është plotësuar pjesërisht;**
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8; gërmat “a”, “b”, “c”, “d”,) **është plotësuar pjesërisht.**

Në lidhje me mungesën apo plotësimin e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar nga aplikanti si më poshtë:

Neni 9, pika 1: Aplikimi është paraqitur në formatin fotokopje, ndaj, në zbatim të nenit 8, pika 3, të rregullores, shoqëria duhet t’a depozitojë atë në origjinal ose fotokopje të noterizuar/njësuar me origjinalin.

Neni 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- gërma “a”, “b” (akti i themelimit/statuti nëse është hartuar si dokument i ndryshëm/ i veçantë nga akti i themelimit). **Plotësuar pjesërisht.**
- gërma “d” (vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria). **Pa plotësuar**
- gërma “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). **Pa plotësuar**

Neni 9, pika 3: Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave). **Pa plotësuar**
- gërma “b” (paraqitje bilanci financiar të tre viteve të fundit). Shoqëria duhet të depozitojë pasqyrat financiare për vitin 2019.
- gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). **Pa plotësuar**
- Neni 9, pika 4.8, Dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike
- gërma “a”. Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar në GWh sipas viteve; **Pa plotësuar**
- gërma “b”. Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj. **Pa plotësuar**
- gërma “c”. Lista e kontratave të mëparëshme të realizuara (nëse ka patur), **Pa plotësuar**

Për gjithë sa më sipër, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, t’i paraqesë ato brënda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI